



Historia e polemikave hebreo-muslimane

Description

Moshe Perlman

Fragment i marrë nga artikulli i Moshe Perlman-it shfaqur në: "Encyclopedia of Religion, second edition, Thomson Gale 2005

Në kapërcyell të shekullit të tetëmbëdhjetë shumica e hebrenjve jetonin në vendet myslimane, ku ndanin, bashkë me të krishterët, statusin e minoriteteve të mbrojtura, karshi një moskundërvënie tolerante dhe në kohë e vende të caktuara, subjekt i diskriminimit, dashakeqjes, abuzimit dhe fyerjes.

Literatura në arabisht, hambari i besuar i dijes teologjike në Islam, rrëfen dhe pasqyron gjendjen përgjatë shekujve. Ndonëse pjesa më e madhe e kësaj diturie ka zanafillë myslimane, hebrenjtë dhe të krishterët kanë ndihmuar hera-herës me shtojca në arabisht në punimet e tyre letrare, përkatësisht, në hebraisht dhe siriakisht.

Literatura e gjerë në gjuhën arabe që u zhvillua në shekujt e hershëm të Islamit ngërtheu vepra mbi besimin, sektarizmin, trajtimin e pakicave, e kështu. Historianët dhe udhëtuesit që kërkonin të skiconin zhvillimin e feve, ngjitjen e Islamit dhe rendjen e tij ngadhënjimtare ndër shekuj e kontinente, sakaq hodhën dritë mbi jomuslimanët dhe fetë e tyre. Shqyrtimet e të dijshmëve lidhur me jomuslimanët, u prirën pashmangshmërisht të bënin me gisht nga shkarjet e ulëta. Kështu, u shfaq polemika, dhe, ndërsa debatet zunë vend, ajo u lëshua në apologetikën shfajësuese.

POLEMIKA MUSLIMANE

Ç'është e vërteta, muslimanët mësuar nga shkrimet e tyre se Islami është një vijimësi e sistemit të mëhershëm fetar dhe ata ishin njohur me qëndrimin e profetit ndaj pararendësve të tyre – hebrenjve dhe të krishterëve. Mbështetur Kuranit, hebrenjtë (të njohur si Jehudë ose Benu Israilë, "Bijtë e Izraelit") ishin një komb i lashtë, që rridhnin nga Abrahami dhe që u larguan nga Egjipti me Moisiun. Të veçuar nga Perëndia, që u dërgoi profetë për t'i mësuar dhe për t'i përdhur, ata prapëseprapë thurnin mëkate dhe paudhësi, duke adhuruar vëçin e artë, duke vrarë profetët dhe duke refuzuar Jezusin, dhe

kështu u dënuan përfundimisht me rrënim, dëbim dhe derdhje nëpër tokë. Më tutje, Kurani dëshmoi se Profeti nuk luftoi vetëm kundër paganëve arabë por u përplas edhe me hebrenjtë që jetonin në Arabi, sidomos ata që banonin në Medine, dhe që kundërvënia që kthyer në ndeshje ushtarake kur hebrenjtë refuzuan të pranojnë Profetin dhe shpalljen e tij.

Këto të dhëna qenë zmadhuar e zbukuruar në kopicat e pafund të traditës (hadith) që u nxor në dritë në ditët e para të Islamit dhe u pasurua më tej nga një tur interpretues, ndërkohë që fjalët që hidhte Kurani mbi historitë biblike u dhanë frymë shpjegimeve të dijes së lashtë hebreje. Meqë hebrenjtë paskëshin qenë paralajmëruar mbi ardhjen e Muhamedit, komentatorët myslimanë shpjegonin se ata i shpërfillën këto aludime apo u përpoqën t'i interpretonin ndryshe ose t'i zhduknin.

Ata, edhe trilluan histori nga israilijat (rrëfime nga epoka e Benu Israilëve) që u thurën enkas për të mashtruar besimtarët e sinqertë. Të konvertuarit hebrenj, gjithashtu furnizuan me informacione – megjithëse të rreme – mbi dijet dhe të shkuarën hebraike. Ka'b el Ahbar është prototipi i tyre; një hebre nga Jemeni, ai përqafoi Islamin një duzinë e gjysmë vjet pas vdekjes së Profetit dhe u konsiderua ekspert i shkrimeve të mëparshme. Me sa duket, shpirti anti-hebre i të krishterëve të lindjes së afërt kaloi në Islam bashkë me konvertimet e të krishterëve. Polemikën më të vjetra, që mund të gjurmohen në debatet e shekullit të tetë dhe të nëntë në oborrin Abasid në Bagdad, zakonisht u drejtohen hebrenjve dhe të krishterëve bashkërisht. Dalëngadalë fillon të dalë në shesh literatura polemike drejtuar enkas hebrenjve, duke filluar me kapitujt e veçantë mbi judenjtë dhe judaizmin dhe me veprat e hebrenjve të konvertuar në Islam. Paçka se këto vepra përmenden herët nga historianët arabë, ekzemplarët më të hershëm të mbijetuar datojnë nga shekulli i njëmbëdhjetë. Ibn Hazmi. Vepra më e hershme e njëmendtë, e ruajtur, e polemikës islamike kundër judenjtë dhe Judaizmit rrjedh nga pena e Ibn Hazmit (1064), një figurë e kulmtë e mësimave islamike dhe literaturës arabe në Spanjë. Ai e shqyrtoi këtë temë në mënyrë të përsëritur dhe është figura më madhore e letrave arabe që e ka shtjelluar atë.

Sa duket Ibn Hazmi parandjeu se shtegu u tij përpjetë suksesit politik në mbretërinë e Granadës që zënë nga epërsia e Hebrenjve, posaçërisht nga kryepari i tyre, Ibn Nagrela (njohur në mesin e komunitetit hebre si Shemu'el ha-Nagid, 993-1056 e.s.), një administrator i arrirë, diplomat dhe prijës ushtarak. Të dy, Ibn Hazmi dhe Nagid shkruan për teologjinë, si njëri dhe tjetri ishin poetë, njëri shkruante në arabisht e tjetri në hebraisht. Ata qenë pjekur me njëri-tjetrin rreth të njëzetave, por takimi i tyre nuk që ndihmues për respektin dhe vlerësimin e ndërsjellë.

Vepra më e madhe e Ibn Hazmit, Kitab el-Fisal ve el-Nihal (Libri i Grupeve dhe Sekteve), një vrojtim i teologjisë, një seksion prej afro 130 faqesh ia kushton kritikës së besimeve dhe shkrimeve hebraike. Pasazhe nga shkrimet hebraike, të cituara për të nxjerrë në shesh të metat e tyre, ndiqen ngapërplotës kuranorë, që janë përmendur për të shfaqur përsosmërinë e tyre përmes krahasimit. Ibn Hazmi shpalos një njohje të mirë të Zanafillës, por dituria e tij për pjesën tjetër të librave hebraike është gjymtë dhe ai nuk arrin të dallojë të dhënat biblike nga legjendat e mëvona. Ka mundësi që ai të ketë përdorur një rend të tërë pasazhesh të përshtatshme (“dëshmi”), të endura me qëllim nga të tjerët. Madje ai citon disa terma të diturive Talmudike. Ai shpreh interesim për prejardhjen e fjalëve hebraike por edhe këtu ai bie pre e keqinformimit: duke përmendur një informator, ai shpjegon, për shembull, seemri Izrael buron nga Asar El (“ai pengoi Zotin”, Zanafilla 32:25-31, ku Jakobi përfytyret me qeniehyjnore dhe ngadhënjën), duke ngatërruar rrënjët hebraike Esr dhe srh.

Në këndvështrimin e tij, shkrimet hebraike janë përplot me kundërthënie, absurditete, antropomorfizma, dhe përmbajtje të pahijshme e të pavenda. Myslimanët nuk duhet, asfare, të ndjejnë nderim karshi shkrimeve të të krishterëve dhe hebrenjve, argumenton ai, dhe duhet t'i flakin këto shkrime të gabuara dhe të shfytëruara. Nderimi i shkon vetëm të vërtetës dhe bukurisë së papërsëdytshme të Kuranit.

Ibn Hazmi është veçanërisht i etur të nxjerrë në dritë mospajtimet në librat biblikë, sidomos kur përfshihen numrat, siç ndodh me paraqitjet e ndryshme të kohëzgjatjes së skllavërisë në Egjipt apo të popullsisë së Izraelit në vitet e endjes nëpër shkretëtirë. Të tjera kundërshti, ai pretendon t'i pikasë në tekstin që përmban njoftimin në Eksodin 7:20-22, se pasi krejt uji në Egjipt u kthye në gjak, magjistarët vendas e përsëritën veprimin: ku, ai pyet, a e shfrytëzuan ata ujin për të treguar mjeshtërinë e tyre? Njëlloj, duke cituar Eksodin 12:38, ai shtron pyetjen se ku i morën çifutët gjithë atë mizëri bagëtish në shkretëtirë, dhe më tej, nëse ata patën kaq shumë bagëti, pse u qanë për mungesën e mishit? Si pasazhe antropomorfiste, ai vë gishtin te “Zoti është një luftëtar” (Eks. 15:3); “Dhe panë Perëndinë e Izraelit. Nën këmbët e tij ishte si një dysheme e punuar me safir” (Eks. 24:10); si dhe të folmet e Zotit në Eksodin 33 ku ai “fliste me Moisiun ballë për ballë...Dhe ai tha akoma: “Ti nuk mund të shikosh fytyrën time ... Pastaj do ta tërheq dorën dhe ti do të më shikosh nga kurrizi: por fytyra ime nuk mund të shihet” (vv. 11, 22–23).

Tjetërsoj nga Kurani, Ibn Hazmi argumenton se shkrimeve hebraike u mungojnë njoftimet e dënimit dhe shpërblimit në jetën e pasosur. Sidoqoftë, vetë Kurani përmend shpalljet biblike, duke veçuar atë të Moisiut. Si ka mundësi? Ngaqë, mëton ai, ekzistonte një shpallje e vërtetë e fjalës hyjnore për Moisiun, por ajo nuk u ruajt. Ngërdheshjet e dendura civile, luftërat, pushtimet dhe disfatat në Izraelin e njëhershëm, rrënuan jo thjesht mbretëritë hebraike, por edhe arkivat e tyre dhe bashkë me to, edhe shkrimet, të cilat u shkuan në flakë. Nuk kishte një traditë të pakëputur të të mësuarit. Në të vërtetë, mund të kishte vetëm një ekzemplar të shkrimeve në duart e klerikëve, të cilët njihnin vetëm kapituj ose pjesëza të tij. Në Babiloni, prifti Ezra sajoi shkrimet hebraike nga mbetjet e shpalljes në mbamendjet e priftërinjve të tjerë dhe nga shtesat e veta.

Këtu Ezra është dënuar si një mjeshtër i mashtrimit pa zotëruar arsyeshmëri dhe ndërgjegje (po aq edhe dituri matematike). Tashmë, Ibn Hazmi tregon nga Ezra, si farkëtusin e fesë së re përgjatë robërimit babilonas, përmes zëvendjes së shërbesës në sinagogë me tempullin themeldalë të Solomonit. Qysh prej ditëve të Moisiut, thotë ai, Ligji i Përtërirë 32 është i vetmi kapitull i shkrimeve

judaike që u është mësuar njerëzve, madje edhe ky kapitull – të cilin ai e citon tërësisht – është i mbushur me paragrafë që nuk mund të kenë prejardhje hyjnore, siç janë vargjet 20-22: “Zoti është babai i tyre”. Sekush që i njih çifutët, zgjatet autori ynë, e di se ata janë një turmë e fëlliqtë dhe e patru, të pështirë, të ulët, besëprerë, zemërlepui, të përçmuar, gënjeshtarë. Që këtej, myslimanët duhet të kërkojnë t’i udhëzojnë bijtë e Izraelit, jo përmes shkrimeve të gatuar nga Ezra por përmes Kuranit, i cili përmban të dhëna për profetë (si Hudi dhe Salihu), që për ta ishin të panjohur.

Ibn Hazmi pohon se çifutët hedhin poshtë shfuqizimin e shkrimeve të tyre dhe ndonjë sugjerim të shkrimeve të periudhës pas Moisiut, qofshin prej Jezusit apo prej Muhamedit. Për ta, vendimi i Zotit të Gjithëdijshëm është i pandërrueshëm dhe nuk mund të ketë korrigjime e teka në vullnetin hyjnor. Pa një ndryshim të tillë të befasishëm (badad) në pëlqimin hyjnor, gjithësejsh, një shkrim i ri nuk do të ishte i mundshëm dhe kështu, ata pohojnë, do të binte ndesh me gjithëdijen hyjnore. Por kjo është e gabuar, kundërshton Ibn Hazmi. Rregullat janë urdhëresa për të përmbushur vepra të caktuara përgjatë një periudhe të kufishme kohe, matanë të cilës ata mund të shndërrohen në të kundërtat e tyre. Rrethanat hapësinore dhe kohore janë të njohura për Zotin dhe është vullneti i tij të falë jetën, vdekjen dhe ringjalljen, fuqinë, rimëkëmbjen, virtytin dhe ligësinë, besimin dhe devijimin. Për hebrejtë puna është e lejuar të premtëve, por është e ndaluar të shtunave, që të dielave të bëhet sërish e lejuar.

Ç’është e vërteta, hebrejtë pranojnë se ligji i Jakobit dallon nga ai i Moisiut. Jakobi u martua me Leahën dhe Rakelën, të cilat ishin motra, sakaq ligji i Moisiut (Levitiku 18:18) i ndalon kësifar martesash. Populli i Gabaonit i shpëtoi asgjësimit dhe u kthye në druvarë dhe bartës uji, si shpagim për arritjen e një marrëveshje të gënjeshtërt me Jozueun (Jozueu 9). Zemërata e Zotit desh i fshiu nga faqja e dheut Izraelitët por lutja e zjarrme e Moisiut bëri që Zoti të ndjejë keqardhje. (Eksodi 32:10-14). Abrahami u nxori gjizë, qumësht dhe mish engjëjve (Zanafilla 18), por kjo nuk ishte një menu e drejtë (siç është zbritur në Ligjin e Përtërirë 14:3-21 dhe gjetiu).

Ibn Hazmi ngutet të nxjerrë në pah shkarjet e dëshmuara në familjet e figurave biblike, me theks të veçantë në përhapjen e shturjes morale në gjirin e tyre. Familjet e patriarkëve, profetëve dhe mbretërve janë damkosur me gjaktrazim dhe imoralitet: Abrahami që martuar me Sarën, motrën e tij; Loti që kandisur me të bijat; Reubeni kreu marrëdhënie me Bihahën, konkubinën e të atit; prej Judës dhe resë së tij rrjedh Davidi, Solomoni dhe Mesia i fortpritur.

Pak shembujt e dijes postbiblike që ai njih, mbase prej Karaiteve, e tronditën atë si “përrallat e plakave”: të dhëna, për shembull, traktatet e lashta Shi Eur Qomah mbi matjen e trupit hyjnor; vrerosjen e Zotit për shkak të rrënimit të Tempullit; përmendja e engjëllit Metatron si “Zoti më i vogël.” Ai rrëfen, po ashtu, se me fjalët e hebrejve, Pali që shpënë te dishepujt e Jezusit që t’i shpërudhë ata në besimin në karakterin hyjnor të Krishtit. Si rrjedhim, Ibn Hazmi vjen në përfundimin se çifutët janë gënjeshtarë dhe batakçinj. Ky tipar buron me zhvatjen nga Jakobi të parëlindjes së Esaut (Zanafilla 25:29-34) dhe bekimin e Isakut (Zanafilla 27). Ndonëse kam njohur shumë syresh (hebrej) – shprehet ai – vetëm dy prej tyre më kanë dalë besnikë.

Anipse ai ruan mendimin se shkrimet hebraike janë falsifikime dhe dërdëllitje, kur vjen puna për t’i flakur tej plotësisht dhe për t’u mbështetur në Kuran, ai nuk mund të lerë pa përmendur disa fragmente që sa duket u shkojnë për shtat pikëpamjeve myslimane. Në këtë udhë, ai pranon Ligjin e Përtërirë 33:2; “Dhe u tha: “Zoti erdhi nga Sinai dhe u ngrit mbi ta në Seir; u paraqit në madhësinë e tij nga mali Paran”, si një paralajmërim për ardhjen e Jezusit (Nga Seiri në Edom, njëjtësuar më vonë me botën e krishterë, ndërsa Parani u mor sikur i aludohet Mekës). Njëlloj, ai zbulon në Ligjin e Përtërirë

(“Unë do të nxjerr për ta një profet nga gjiri i vëllezërve të tyre”) një njoftim për misionin e Muhamedit, meqë arabët, barku i Ismailit (Ishmael), janë vëllezërit, nga gjiri i të cilëve do të dilte profeti.

Ibn Hazmi shkroi edhe një traktat kundër një broshure hartuar nga Ibn Nagrela (o i biri) kundër Kuranit. Megjithëse nuk mundi të shtjerë në dorë një dorëshkrim të këtij teksti dhe kishte dëgjuar për të vetëm nga përgënjeshtuesit myslimanë të autorit, ai vazhdoi të hedhë baltë mbi kryeparin çifut dhe të pafeve të tjerë, që qenkëshin bërë kaq kryelartë. Në këtë traktat ai shfryn edhe ndaj sundimtarëve myslimanë, që shijonin pallatet e tyre madhështore dhe kishin harruar detyrën e tyre për të ruajtur mbizotërimin e rreptë të myslimanëve ndaj të pafeve.

Ndikimi i shkrimeve polemizuese të Ibn Hazmit nuk është i qartë. Ai nuk është marrë për bazë nga autorët e mëvonshëm, dhe ka mundësi që ndjekja e shkollës Dhahirije të teologjisë – një pakicë e veçuar brenda myslimanëve synitë – mund t’i ketë vënë cak përhapjes së pikëpamjeve të tij. Megjithatë, të paktën një trakt i shkurtër hebre, Ma’amar al Yishma’el (Traktat për Ishmaelin) i shekullit të trembëdhjetë e Shelomoh ben Avraham Adretit, përmend dhe përgënjeshton fragmente të argumenteve të Ibn Hazmit për falsifikimin. Në ndonjë rast, gjithë sferës së debatit Myslimano – Hebre i jepej interpretimi i parë sistematik në veprën e Ibn Hazmit: shfuqizimi (naskh), shtrembërimi apo falsifikimi i shkrimeve (tahrif), antropomorfizmi (texhsim) dhe lajmi i ruajtur i Islamit dhe profetit të tij (alaam).

Samuel al-Maghribi. Broshura Ifham el-Jehuud (Të heshturit hebrejtë), shkruan në 1163 në Maragha (Irani i veriut), është polemika më e rëndësishme dhe më me peshë e myslimanëve ndaj hebrejve. Autori i saj është Samuel el-Maghribi (1125 – 1175), një çifut që u konvertua në Islam dhe shkroi broshurën për të shpallur konvertimin. (Nuk duhet ngatërruar me broshurën në arabisht të Samuel Marokanusit, një i konvertuar në Krishtërim, e cila qe përkthyer në latinisht dhe më vonë edhe në shumë gjuhë perëndimore).

Babai i Samuelit ishte një poet hebre pa ndonjë emër, i cili me sa duket u arratis nga Maroku gjatë një vale persekutimesh, u ngul në Bagdad, ku u martua me një grua nga një familje e shquar. Samueli, i cili studioi pranë filozofit me zë Ebu el-Barakat (edhe ky një hebre i konvertuar në Islam), fitoi një nam të madh si matematikan dhe fizikant. Mësimet hebraike duket t’i ketë pasur të kufizuara. Në një autobiografi bashkëngjitur broshurës së tij në vitin 1167, ai pretendon se qe shtyrë të ndërronte fenë nga mendimi racional përgjatë përvijimeve matematike. Sado që ai përshkruan vegimet e profetëve Samuel dhe Muhamed, ai nuk heq dorë se argumentet e pastra logjike ia mbushën mendjen.

Një shenjë vetë-admirimi shquhet kudo:

Atëherë, pasi e kisha stërvitur mendjen me studimet matematike, veçanërisht gjeometrinë me vërtetimet e saj, ju drejtova vetes për ta pyetur mbi ndryshimet ndërfaqetare dhe doktrinale ... e kuptova se arsyeja ishte gjykatësi suprem dhe se parimet e saj duhet të rrënjosen përgjithësisht ... në botën tonë.... Ne kuptojmë se nuk na shtrëngon neve të pranojmë traditat stërgjyshore pa vënë në provë saktësinë e tyre....Mbështetja e thjeshtë tek etërit dhe tradita, nuk është provë....Unë e kuptoj çifutët nuk kishin prova...për...Moisiun tjetërsoj nga të dhënat e zinxhirit të transmetuesve, i cili është pranuar për Jezusin dhe Muhamedin ashtu si për Moisiun...atëherë, që të tre janë profetë të vërtetë....Unë nuk e kam parë Moisiun...as jam gjendur pranë mrekullive të tij dhe të ndonjë profeti tjetër....Një njeri i mençur nuk mund të besojë njërin dhe të hedhë poshtë të tjerët....Më saktë, është detyrë e arsyeshme që, o të besohen të gjithë o të refuzohen të gjithë....Sa për refuzimin, këtë s’e thotë mendja. Ne mësojmë se të gjithë ata na predikonin morale të fisme, mbronin virtytet dhe luftonin veset,

dhe ujdisë botën në një formë të dobishme për njerëzimin.

Në këndvështrimin e Samuelit, rekordi i hebrenjve në përparimin shkencor nuk mund t'i përqaset atij grek dhe të tjerëve; njëlloj, literatura e myslimanëve është shumë më lart.

Çështja kyç e abrogimit është vërtetuar si logjike ashtu edhe historike. Legalistët hebrenj, thoshte ai, ofrojnë mendime të ndryshme në lidhje me këtë çështje; si mund të jenë ato të gjitha me origjinë hyjnore? Në fakt vet ligji është i mbushur me kundërtënie: p.sh. tek Eksodi të gjithë të parëlindurit ishin shenjtëruar për adhurim (13:2); tel Libri i Numrave, vetëm Levitët (8:18). Meqenëse pastrimi me hirin e të vdekurit dhe me ujë (Numrat 19:11, 19:16, 19:17) nuk vlente më atëherë, pohonte ai, hebrenjtë duhet ta konsideronin veten e tyre si të papastër. Lutjet përgjatë ekzilit, shpërndarjes dhe shpërsës për restaurim janë qartësisht me origjinë të vonshme, madje ato nuk duhet të kishin qenë fare pjesë e Dhjatës së Vjetër duke pasur parasysh urdhërimin kundër shtimit apo pakësimit të fjalës hyjnore.

Janë përmendur një sërë argumentesh për të dëshmuar se Jezusi dhe Muhamedi qenë parashpallur në shkrimet: Ligji I Përtërirë 18:15 parathotë një profet prej vëllezërve të tyre; te Zanafilla 17:20, Zoti premtonte ta shumojë Ismaelin (këtu germat e fjalëve hebraishte për "jashtëzakonisht", bi-mod, meod, numerikisht të barabarta me 92, që përfaqëson vlerën numerike të emrit Muhamed); Zanafilla 21:21 lidhet me tre shpallje profetike, e fundmja në shtëpinë e Ismaelit, që i bie të jetë ajo e arabëve.

Kritika e shkrimeve vazhdon. Me fjalët e Samuelit, shkrimet u zhdukën shumë kohë më herët si pasojë e peripecive në historinë e hebrenjve. Mbreti Saul (1 Sam. 22:16-20) masakroi degën familjare të Aronit. Shumë shekuj kaluan para se Ezra, një prej aronidëve priftërorë, të rikrijonte shkrimet. Meqenëse priftërinjtë e kursenin pushtetin enkas për mbretërit, ai shtoi dy histori nënçmuese në rrënjët familjare të Davidit. Njëra, ajo e bijave të Lotit (Zanafilla, 19), rrënjos origjinën e Moabit dhe kësisoj paligjshmërinë e Ruthit, stërgjyshes së Shtëpisë së Davidit, madje, asaj të mesias së pritur. Historia tjetër (Zanafilla, 38) tregon se Boazi, bashkëshorti i Ruthit, rrodhi nga marrëdhënia e Judës me Tamarën.

Mes gjithë këtij kritizimi, Samueli po ashtu akuzon se ligji është despotik dhe një barrë e rëndë (isr), sikundër shfaqet në rregullat dietike veçmas për çifutët dhe veçmas për joçifutët. Hebrenjtë, përmend ai, e quajnë Muhamedin budalla dhe të çartur (meshugga E, cf. Hos. 9:7) dhe po ashtu si të "papërshtatshëm" (Heb., pasul, duke rimuar me termin arab "rasul", "i dërguar", emër për Profetin si i Dërguar i Zotit); njëlloj ato i drejtohen Kuranit si "i turpshëm" (kalon).

Pa frikë, ka një ngjashmëri midis argumenteve të Ibn Hazmit në shekullin e njëmbëdhjetë dhe atyre të Samuelit të shekullit të dymbëdhjetë. Si duket, ata riprodhonin të njëjtat tekste lidhur me pasazhet biblike dhe teorinë se Ezra është autor i Pesëlibërshit (hipoteza mbi rolin e Ezrës në historinë e shkrimeve arrin deri në tekstet e vona helene; shih Bibelkritik in der späthellenistischen Literatur, Lwów, Edmund Stein, 1935).

Trakti i Samuelit, ashtu siç duhej, tregoi shumë ndikim si një burim i autorëve myslimanë përgjatë shekujve. Argumentet e tij rishfaqen në El-Exhvibeh el-Fakhireh (Përgjigjet e përsosura) shkruar nga

Egjiptiani El-Karafi (1285) dhe në veprat e Ibn Kajim El-Xhevzijas (1350). Duke kopjuar broshurat burimore të Samuelit, që përmbante pasazhe me germa hebraike të ndjekura nga transliterimi dhe përkthimi në arabisht, shkruesit e mëvonë kishin harruar gërmat e huaja hebraike. Pamfleti u botua në Egjipt në vitin 1939 dhe sërishmi në 1960.

El-Rakil'i. Në rrethana paksa të ndryshme doli trakti Texhid el-Mil-leh (Ndihmë për Fenë) e Ebu Zekerija Jahja El-Rakil'i, shkruar në Hueska në vitin 1360 dhe i synuar kundër hebrenjve dhe të krishterëve. Ndërsa jetonte në Mbretërinë Spanjolle të Aragonës pas rekonkuistës së krishterë, ai shprehte hidhërimin për rënien e Islamit, përderisa myslimanët u rrëzuan nga pozita mbizotëruese në atë të një pakice të toleruar, dhe veçanërisht për trajtimin e fshatarëve myslimanë nga zyrtarët çifutë dhe agjentët e taksave për llogari të kurorës. Përmes leximit të teksteve biblike të përkthyer, ai "nxori prej tyre pasazhe dhe evidenca me të cilat hidhte poshtë hebrenjtë". Zoti i ka ndëshkuar ata, vlerëson ai, me shpërhapje të përhershme (el-ghaluth el-daim) dhe poshtërim. Ai zë me gojë debate dhe argumente (el-munazaratë ve el-ihthixhaxhë) dhe shpreson që Zoti "të na nxjerrë nga tokat e politeistëve në ato të myslimanëve".

Shkrimet hebraike, thotë ai, dëshmojnë se ata qenë rebelë, të pafe, mosmirënjohës dhe pjella të mallkuara. Ata shkelën një e nga një të Dhjetë Urdhëresat. Sipas skemës historike të El-Rakil'it, Hagari, nëna e Ismaelit, qe gruaja e Abrahamit dhe jo shërbëtorja e tij. Ajo nuk qe një robëreshë e thjeshtë, por bijë e një princi egjiptian, dhe tek e fundit, edhe një skllav mund të jetë profet, si Jozefi, që qe skllavi i Potifarit. Zoti e urdhëroi Abrahamin që të sakrifikonte djalin, pastaj e ndaloi patriarkun ta bënte këtë. Kjo, vjen në përfundim El-Rakil'i, është një rast i hapur i shfuqizimit. Por edhe pse shkrimet judaike janë të pabesueshme, ai citon Isaian 21:7 ("një kope gomerësh, një kope deveshë") si një një paralajm për misionet e Jezusit dhe Muhamedit, përkatësisht.

Broshura e El-Rakil'it i përket një niveli më të ulët debati të ngritur midis dy komuniteteve të shtypura nën zotërimin e krishterë. Gjithëpoq, në këtë kategori veprash më pak të ndërlukuara, drejtuar më shumë lexuesit të rëndomtë mysliman bëjnë pjesë edhe dy broshura të të konvertuarve çifutë të shekullit të katërbëdhjetë. Njëra, është ajo e Seid ibn Hasani i Aleksandrisë, i cili, në 1320, kur jetonte në Xhamin e Madhe të Damaskut, shkroi një shpjegim për konvertimin e tij. Ndërsa ishte i sëmurë keq në pritje të vdekjes, ai dëgjoi papritur një zë që e shtynte të lexonte një sure të Kuranit. Ai u bind dhe u shërua në mënyrë të mrekullueshme. Ai u bë një besimtar i zjarrtë saqë u kthye ndaj pabesimtarëve të krishterë dhe çifutë dhe në traktet e tij, që citojnë tekste biblike, ai tregon absurditete dhe shtrembërime të sigurta.

I ngjashëm është edhe rasti i Abdel Hakk el-Islami nga Ceuta, i cili shkroi afër fundit të shekullit. Në përforcim të mbështetjes mbi gimatrijeh, argumenti nga vlera numerike e emrave dhe fjalëve, ai akuzonte çifutët për adhurimin e zjarrit, quante Ahab mëkatarin (1 Mbr. 16–18) një mbret të drejtë, një besimtar mysliman, dhe paraqiste frazën hebraike "xhentili është si qeni" si një tekst autentik.

APOLOGJETIKA HEBREJE

Veprat hebraike në arabisht dhe hebraisht, u rrek të mbrohej karshi sulmeve islamike. Këtë qëllim kishin përgjigjet apologjetike ndaj argumenteve myslimane formuan një metodologji për të riinterpretuar

kauzën çifute në dritën e atmosferës së re intelektuale nën regjimin e Islamit.

Maimonides. Ndonëse Moses Maimonides (Mosheh ben Maimon, d. 1204) bëri thirrje për të mos u përfshirë në debate me myslimanët, për shkak se ata nuk e pranonin Biblën hebraike si një tekst të shpallur dhe në këtë mënyrë nuk ndanin të njëjtin burim, Letra e tij për Jemenasit është praktikisht një traktat polemik. Qëllimi i saj ishte të përgatisë publikun e sinagogave për t'iu kundërvënë argumenteve myslimane: “Disa zemra janë përhumbur . . . besimi është dobësuar,” u thotë ai lexuesve të tij. “Besimi ynë është besimi hyjnor i vërtetë dhe i mirëfilltë që na u zbrit përmes Moisiut . . . Në sulmin ndaj nesh, disa përdorin forcën e egër; të tjerë, polemikën. Krishtërimi dhe Islami i ndërthurin të dy metodat”.

Polemistët myslimanë, vijon ai, mëtojnë të kenë zbuluar emrin dhe vendin e Muhamedit në shkrimet hebreje (Zn. 17:20; LP. 33:2, 18:15). Hebrenjtë e konvertuar në Islam (me sa duket Samueli) që përmendin këto vargje, nuk mund t'i besojnë njëmend ato; qëllimi i tyre i vërtetë është që të fitojnë ndere në sytë e xhentilëve. Myslimanët, pa qenë të zotë të tregojnë qoftë edhe një varg, akuzojnë hebrenjtë se kanë shtrembëruar apo fshehur shkrimet. Ç'është e vërteta, rrëfen ai, shkrimet kanë qenë përkthyer në greqisht, aramaisht dhe latinisht shekuj para se të shfaqej Muhamedi.

Si pasojë e mëkateve tona . . . Zoti na ka hedhur neve në mesin e këtij populli, arabëve, të cilët na kanë përndjekur neve shumë ashpër kanë themeluar një legjislacion vdekjeprurës dhe të njëanshëm ndaj nesh. . . . Asnjë komb më parë nuk na ka ngarë, fyer, përlulur dhe urreyer sa ata. . . . Paçka se ne ne vuajme dhe prapë zgjedhim të mbetemi në paqe, ata nxisin grindje dhe rebelime, ashtu siç parathoshte Davidi (Ps.120:7): “Unë jam i tëri paqe, por kur unë flas, ata janë për luftë”.

Ai e përmbyll me një paralajmërim për rrezikun që përfshin leximi i letrës së tij, por ia shpreson se “sekreti i Zotit do të mund t'u besohet atyre që ia kanë frikën Atij (Ps.23:14)”.

Ibn Kamunah. Si një rast i veçantë qëndron Tenkih el-ebheth fi el-milel el-thelath (Kërkim Kritik në Tre Fetë), shkruar në Bagdad në vitin 1280 nga Sad ibn Mensur Ibn Kamunah. Me kalifatin nën mongolët, Islami nuk mund të shihej më si feja e pushtetit por prapëseprapë ajo mbeti feja mbizotëruese e masave. Një rishikim i librit të Ibn Kamunës në një predikim para një audience xhamie të së premtes shkaktoi një sulm turme të zemëruar, dhe autorit i'u desh të ikte nga qyteti fshehur në një sënduk.

Vepra nis me një diskutim të përmbledhur mbi fenë në përgjithësi, e ndjekur nga kapituj për secilën nga të tri fetë monoteiste. Dy të tretat e librit i është kushtuar Islamit dhe është bazuar mbi tekstet myslimane; ai është shkruar në një frymë të pazakontë paanësie. Megjithatë, ndonëse Islami dhe profeti i tij marrin një trajtim të ndershëm, mbresa përfundimtare nuk është e këndshme.

Kapitulli mbi Judaizmin përmban një vrojtim të shkurtër të të dhënave biblike dhe besimeve judaike, ndjekur nga shtatë vërejtje të ngritura nga Samuel el-Magribi. Këto vërejtje janë rrëzuar me argumente që pasqyrojnë këndvështrimet e Jehudah ha-Levit dhe Maimonidesit. Ibn Kamunah tregon se komunitetet mund të jetojnë strehë më strehë me njëri-tjetrin për shekuj me radhë dhe ta njohin njëri-tjetrin vetëm në mënyrë të përkorë.

Por lidhja e myslimanëve me hebrenjtë nuk e bën të nevojshëm kërkimin mysliman mbi atë çka pohojnë çifutët, veçanërisht sa kohë këta të fundit janë penguar ta shpallin besimin e tyre, dhe sa kohë

librat e tyre [kanonikë] janë shkruar në një gjuhë që myslimanët nuk e kuptojnë. Marrëdhënia midis një shumice dhe pakice i ndikon ato në mënyra të ndryshme. Kështu, kur një pakicë gjuhësore krijon marrëdhënie me një shumicë gjuhësore, e para e mëson gjuhën e të dytës, sakaq e dyta nuk e kryen një proces të tillë, ose në rastin më të mirë, e kryen atë shumë më vonë. Aq më tepër që, megjithë marrëdhëniet e dendura të pjesës më të madhe të çifutëve me myslimanët, shumë syresh nuk i njohin akoma as doktrinat themelore islame të njohura nga myslimanët e thjeshtë, le më elita. Është edhe më e natyrshme që një gjendje e tillë të përshtatet në anën myslimane, ose, tek e fundit, t'i vëmë të dy palët në të njëjtat pozita [në padijen e ndërsjellë].

Veç kësaj, myslimanët vetë janë të ndarë në fraksione të ndryshme që haheshin me njëri-tjetrin. Ai rendit grindjet e brendshme të krishtera dhe vëren:

Unë nuk munda të marr përgjigje për shumicën e këtyre grindjeve në diskutimet me të krishterët; unë ofrova këto përgjigje në emër të tyre dhe në plotësim të kërkimeve në besimet e tyre.

Kjo ndolli një admirim nga kundërshtarët e krishterë. Kur diskuton mbi fraksionet myslimane dhe mëtimet e përkatëse, ai vëren:

Ka vend për spekulim në këtë çështje. Përkatësisht, shumë gjëra që një person i dëshiron, për shkaqe tokësore, ai kryen vepra për të cilat, siç është edhe vetë i sigurtë, themeluesi i asaj feje ka parathënë një ndëshkim të rreptë në botën tjetër. Ky besim nuk do ta përmbajë njeriun nga të kryerit e asaj këtij mëkati të ndaluar. Kështu ndodh në rastin e shkelësit të kurorës, konsumuesit të verës apo shpifësit. Nga ngutja për të fituar mbi kundërshtarët, natyra njerëzore do të nxisë trillimin e argumenteve që i mbajnë anën fesë së vet. Duke mos marrë parasysh ndalimin e gënjeshtërisë, ndokush do të shpikë argumente të tilla mbi fenë, ashtu që të fitojë ndonjë shpërblim. Kjo mund të bëhet edhe nga njerëz që i janë bashkuar fesë krejt rastësisht – pa ndonjë bindje të thellë por më shumë të tërhequr nga dëshira për sukses, siç ndodh sot që shumë njerëz i bashkëngjiten Islamit, me qëllim që të ngadhënjëjnë mbi kundërshtarët, anipse ata nuk besojnë me bindje. Nëse pohimet tuaja do të ishin të njëmendta, asnjë myslimani nuk do t'i duhej të stiste gojëdhëna; mirëpo, e kundërta është rasti në fjalë.

Duke përmbledhur argumentet për profetësinë e Muhamedit, ai hahet duke thënë se ato mbeten të paprovuara dhe vëren se:

Ja pse, gjer më sot, ne nuk shohim kërkënd që të kthehet në Islam pa terror, apo në kërkim të pushtetit, apo për të shmangur taksat e rënda, apo për t'i shpëtuar poshtërimin, apo në qoftë burgosur, apo në ia pastë marrë mendjen një grua myslimane, a për ndonjë arsye të ngjashme. Ashtu siç nuk na zë syri ndonjë jo mysliman të respektuar, të pasur dhe fetar të lexuar në të dy fetë, të veten dhe Islamit, që të jetë kthyer në fenë Islame pa ndonjë nga arsyet e lartpërmendura ose të ngjashme me to.

Njëllonj, ai hedh poshtë argumentin se ngadhënjimi dhe pushteti janë prova të miratimit hyjnor:

Po si mund të jetë mizëria e ndjekësve, provë për të mëtuar vërtetësinë, kur dihet se idhujtarët dhe zjarrputistët mbizotëruan për mijëra vjet skaj më skaj botës? Unë kam parë se ata nuk kanë ndonjë argument kundër përveç rrahgjoksjes se feja Islame duket të kapërcejë në shifra fetë e tjera dhe se ajo ndërthur një kulm përsosjeje sasiore dhe cilësore të paarrirë nga ndonjë fe tjetër e njohur. Ama, kush e mëton këtë nga inati, nuk ka për të gjetur dot prova për të.

RËNIA E STILIT

Pas 1400-ës, polemika myslimanë që një përsëdytje kok e këmbë e argumenteve të mëhershme të publikuara në broshura të pavlera. Një përjashtim i shquar është një debat i përcjellë në 1769 nga një studiues persian, Sejid Muhamed Mehdi Tabatabai; i njohur përmes një vlerësimi në arabisht, ky rast duket të ketë qenë cilësuar nga një butësi dhe zemërgjerësi e pazakontë. Brenda Perandorinë Osmane, me shumë mundësi nga qarqet e krishtera, përflitej kohë pas kohe se çifutët përdornin gjak (të krishterë) për të gatuar bukën pa maja të Pashkës. Kjo “shpikje e përgjakur” doli në Damask në 1840, dhe që atëherë dilte në dritë herë pas here.

Në shekullin e nëntëmbëdhjetë, talljet dhe argumentet anti-hebraike zunë të depërtojnë botën myslimane nga burime perëndimore, si fillim posaçërisht nga antisemitizmi francez. Në shekullin e njëzetë, konflikti në Palestinë dhe ngritja e Zionizmit shërbyen si shkëndija për të rikthyer prushin e kundërvënies mesjetare si një shtojcë fetare në përplasje. Por literatura e pikëpamjes religjioze ka dhënë prova të një varfërie të skajshme në përmbajtje, e mbyllur vetëm në përsëritjen e argumenteve prej shekujve të njëmbëdhjetë dhe dybëdhjetë: pasazhe të shkëputura nga Kurani dhe gojëdhënat, një lumë epitimesh që cilësonin hebrejtë si përjetësisht të mbrapshtë, të qëllimkëqij nga myslimanëve, ndaj myslimanëve dhe të krishterëve, dhe në të vërtetë, ndaj krejt njerëzimit, si armiq që gjithherë ngrenë kurthe kundër njerëzores dhe të mirës, për hir të mbizotërimit të botës nga çifutëria dhe Izraeli.

Thënë me pak fjalë, polemika myslimane drejtuar hebrejve është një letër e kotë e mbushur me shkrime jothlebësore dhe me shumë pak interes edhe për vetë myslimanët. Nga ana e tyre, hebrejtë ruajtën një profil të ulët debati dhe nuk parapëlqyen që të kundërpërgjigjen. Megjithatë mund të gjenden shumë aludime për argumentat myslimanë në predikimet mesjetare, ashtu si edhe në veprat interpretuese dhe fetare.

Përktheu: Vehap Kola

* Nuk jemi doemos dakord me gjithçka që është thënë në këtë artikull

BIBLIOGRAFI

Përmbledhja klasike mbi polemikën në gjuhën arabe midis myslimanëve, të krishterëve dhe çifutëve është *Polemische und apologetische Literatur in arabischer Sprache, zwischen Muslimen, Christen und Juden* e Moritz Steinschneider (1877; ribotuar, Hildesheim, 1965). Studime të tjera të hershme nga Ignác Goldziher në të tijën *Gesammelte Schriften*, 3 vol. (Hildesheim, 1967–1970), dhe “Zur Geschichte der Polemik zwischen Juden und Muhammedanern,” *Zeitschrift der Deutschen Morgenländischen Gesellschaft* 42 (1888):591–675 e Martin Schreiner.

Salo W. Baron e trajton temën, me një bibliografi gjithëpërfshirëse, në “Një Histori Shoqërore dhe

Fetare e Hebrenjve, bot 2, rish & zgj., vol.5 (New York, 1957) fq 82-108. Unë kam shkruar edhe një vërtetim, "Polemika Mesjetare midis Islamit dhe Judaizmit", në fe dhe në epokën fetare, botuar nga S. D. Goitein (Cambridge, Mass., 1974).

Për studime të specializuara, shih "An Early Theologico- Polemical Work," Xhekob Men, Hebrew Union College Annual 13/14 (1937–1938): 411–459; "Polémica religiosa entre Ibn H: azm e Ibn al-Nagrila," e Emilio García Gomez, Al-Andalus 4 (1936): 1–28; "Un tratado morisco de polémica contra los Judios," e Miguel Asín Palacios në Mélanges Hartwig Derenbourg (Paris, 1909), fq. 343–366, ribotuar në të tijën Obras escogidas, vol. 2–3, De historia y filogogia arabe (Madrid, 1948); R. Salomo ben Abraham ben Adereth: Sein Leben und seine Schriften (Breslau, 1863), e Joseph Perles; dhe "El-Jehud fi el-Kuran" e Afif Abd el-Fatah Tabarah (Beirut, 1966). Një pikëpamje izraelite e zhvillimeve moderne është "Arab Attitudes to Israel" e Yehoshafat Harkabi, përkthyer nga Misha Louvish, (Neë York, 1972).

Një numër burimesh origjinale janë gjithashtu të shfrytëzueshme në përkthim. Mes autorëve myslimanë, Kitab el Fisal ve en Nihal, 5 vëll. në 2 (1903; ribot, Bagdad, 1964), është përkthyer nga Miguel Asín Palacios në vëllimin 2 të Abenházam de Córdoba (Madrid, 1927), dhe unë kam përkthyer dhe botuar Samauel el-Magribin, "Ifham el Jehud", (Neë York, 1964). Formulimet e hershme të debatit nga këndvështrimi judaik janë pasqyruar në traktatin e tretë të "The Book of Beliefs and Opinions" të Sa'adijeh Gaon përkthyer nga Samuel Rosenblatt (New Haven, 1948). Të tjera tekste çifute përfshijnë Letren për Jemenin të Moses Majmonides, përkthyer nga Boaz Kohen dhe redaktuar nga Abraham S. Halkin (New York, 1952), dhe Examination of the Three Faiths e Ibn Kamunës: "Një Ese e Shekullit të Trembëdhjetë në Studimin Krahasues të Fesë", (Berkeley, 1971), të cilën unë e kam përkthyer dhe redaktuar

MOSHE PERLMAN (1987) Universiteti i Kalifornisë, Los Anxheles.

Date Created

16/10/2014

Author

erasmusi